

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**  
**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**

**Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave - Komisija za razmatranje žalbi -  
Complaints Review Commission**

06 Prill 2022

Komisioni i Ankesave për procesin e angazhimit të praktikantëve përmes programit të praktikës, i themeluar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM, Nr.Prot 202/2, të datës 25.03.2022, në përbërje: Xhavit Bulliqi-kryesues, Ardita Alidema-anëtare, Tomor Mazreka j-anëtar në pajtim me nenin 130 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative mori këtë:

**V E N D I M**

1. **Ndalohet** efekti pezullues i të gjitha ankesave për procesin e angazhimit të praktikantëve në konkursin e shpallur nga Zyra për Çështje të Komuniteteve /ZKM përmes programit të praktikës të publikuar nga Komisioni Vlerësueses bazuar në Vendimin nr.025/2022 dt.15.03.2022.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

I. Duke u bazuar në "Parimin e të drejtës në mjete juridike" dhe "adresimin e Ankesës" të parapara në nenin 13 dhe 128 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit ka themeluar Komisionin për shqyrtimin e ankesave për procesin e rekrutimit praktikantëve përmes programit të praktikës të publikuar nga Komisioni Vlerësueses bazuar në Vendimit nr.025/2022 dt.15.03.2022.

Gjatë procesit të përzgjedhjes së ka pasur disa ankesa kundër listës së ngushtë të publikuara në faqen e internetit të Zyrës së Kryeministrit.

Duke vepruar në pajtim me nenin 13, 125, dhe 128 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Komisioni ka mbajtur seancën e shqyrtimit të këtyre ankesave.

Komisioni duke pas parasysh “Efektin pezullues të ankesës” të paraparë në nenin 130 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet:

*“Efektet e parashtrimit të ankesës*

- 1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën.*
- 2. Nëse në aktin administrativ përfshihen dy ose më shumë palë me interesa të njëjta, ankesa e paraqitur nga njëra nga palët, pezullon prodhimin e pasojave juridike të aktit ndaj të gjitha palëve të përfshira.*
- 3. Organi publik, i cili shqyrton ankesën, mund të vendosë me akt administrativ, ndalimin e efektit pezullues të tij, nëse vonesa në ekzekutimin e tij mund t'i shkaktojë një dëm të menjëhershëm dhe të riparueshëm interesit publik apo një palë të tretë. Akti për heqjen e efektit pezullues, përveç elementeve të parapara nga neni 47 i këtij Ligji, do të përfshijë arsyetimin e ekzistencës së kushteve të parashikuara nga ky paragraf.*
- 4. Pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit për ndalimin e efektit pezullues në gjykatën kompetente për konfliktet administrative, brenda pesë (5) ditëve nga njoftimi i tij.*
- 5. Gjykata merr vendim brenda pesë (5) ditëve dhe vendosë prishjen e vendimit për shkak të mosekzistencës së kushteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, apo për shkak të disproporcionalitetit të ndalimit të efektit pezullues.*

II. Sipas nenit 130 paragrafi 130.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, parashtrimi i ankesës pezullon prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

Shtyrja e zbatimit të këtij projekti do të ketë si pasojë vështërsi në zbatimin e tij apo edhe pamundësi të realizimit të këtij programi, për shkak të afateve të përcaktuara nga donatori, në këtë rast Ambasada Norvegjeze.

Duke pas parasysh se mjetet për realizimin e këtij programi janë donacion nga Ambasada Norvegjeze dhe për shkaqe të ndryshme, zbatimi i këtij programi ka pas ngecje, ZÇK ka marrë një afat shtesë për realizimin e këtij programi nga Ambasada, afat prej gjashtë muajsh, sa edhe parashihet të zgjasë programi i praktikës.

Në rast se puna praktike e studentëve nuk do të filloj deri pas kalimit të afatit për ankesë ky program mund të anulohet nga ana e donatorit.

Në këtë rast, konsiderojmë se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm i interesit publik, për arsye se siç e dini kanë përfunduar të gjitha procedurat e përzgjedhjes së 100 praktikantëve, gjithashtu do të pamundësohet mbajtja e praktikës nga këta praktikantë, e si pasojë mjetet për realizimin e këtij programi do të kthehen tek donatori. Në situatën që jemi, konsiderojmë se ne si institucion duhet të ndër marrim të gjitha masat e parapara ligjore për të mundësuar realizimin e këtij projekti.

Për më tutje, neni 130 paragrafi 130.3 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative parasheh që efekti pezullues i ankesës mund të ndalohet nëse vonesa e ekzekutimit të aktit administrativ mund të shkaktojë dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm interesit publik.

Sipas asaj që u tha në tekstin e lartë cekur dhe bazuar në parimin e efikasitetit, vonesa në ekzekutimin e tij mund t'i shkaktojë një dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## KËSHILLA JURIDIKE

Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vendimit për ndalimin e efektit pezullues në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Kryesuesi i Komisionit

Xhavit Bulliqi

---

Nënshkrimi:



---

Procesmbajtës

*Adrian Begjini*

---

Nënshkrimi:



---



**Republika Kosovo**  
**Republika Kosovo- Republika Kosovo**  
**Vlada-Vlada-Vlada**  
*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*

*Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave – Komisija za razmatranje žalbi –  
Complaints Review Commission*

06 april 2022

Žalbena komisija za proces angažovanja pripravnika kroz program stažiranja, osnovana odlukom generalnog sekretara KP, br. Prot 202/2, od 25.03.2022. godine, u sastavu: Xhavit Bulliqi-predsedavajući, Ardita Alidema-član , Tomor Mazrekaj-član u skladu sa članom 130 Zakona br.05/L-031 o opštem upravnom postupku donela je sledeću:

**O D L U K U**

- 1. Zabranjuje se** suspenzivno dejstvo svih žalbi na proces angažovanja pripravnika na konkursu koji je raspisala Kancelarija za pitanja zajednica/KP kroz program stažiranja koji je objavila Komisija za ocenjivanje na osnovu Odluke broj 025/2022 od 15.03.2022.
- 2. Odluka stupa na snagu** danom potpisivanja.

**O b r a z l o ž e n j e**

I. Na osnovu "Principa prava na pravni lijek" i "Rešavanja žalbe" predviđenih u članovima 13. i 128. Zakona br. 05/L-031 o opštem upravnom postupku, generalni sekretar Kancelarije premijera je osnovao Komisiju za razmatranje žalbi na proces zapošljavanja pripravnika kroz program pripravničkog staža koji je objavila Komisija za ocenjivanje na osnovu Odluke broj 025/2022 od 15.03.2022.

Tokom procesa selekcije bilo je nekoliko žalbi na uži izbor objavljen na sajtu Kancelarije premijera.

Postupajući u skladu sa članovima 13, 125 i 128 Zakona br. 05/L-031 o opštem upravnom postupku, Komisija je održala sednicu za razmatranje ovih žalbi.

Komisija uzimajući u obzir "Suspenzivno dejstvo žalbe" predviđeno članom 130. Zakona br. 05/L-031 o opštem upravnom postupku koji utvrđuje:

*"Efekti podnošenja žalbe*

- 1. Ako zakonom nije drugačije određeno, podnošenje žalbe obustavlja, po sili zakona, nastanak pravnih posledica upravnog akta, do objavljivanja odluke kojom je žalba rešena.*
- 2. Ako su dve ili više stranaka sa istim interesima uključene u upravni akt, žalba podneta od strane jedne od stranaka, obustavlja proizvodnju pravnih posledica akta protiv svih uključenih strana.*
- 3. Javni organ, koji razmatra žalbu, može upravnim aktom odlučiti o zabrani njenog suspenzivnog dejstva, ako kašnjenje u njenom izvršenju može uzrokovati neposrednu i nepopravljivu štetu javnom interesu ili trećoj strani. Akt za otklanjanje suspenzivnog dejstva, pored elemenata predviđenih članom 47. ovog zakona, sadržavaće i opravdanost postojanja uslova predviđenih ovim stavom*
- 4. Protiv odluke o obustavljanju suspenzivnog dejstva stranka može izjaviti prigovor sudu nadležnom za upravni spor, u roku od pet (5) dana od dana njenog obaveštenja.*
- 5. Sud donosi odluku u roku od pet (5) dana i odlučuje o ukidanju odluke zbog nepostojanja uslova iz stava 3. ovog člana, ili zbog neproporcionalna zabrana efekta suspenzije.*

**II.** U skladu sa članom 130 stav 130.1 Zakona br.05/L-031 o opštem upravnom postupku, podnošenje žalbe obustavlja proizvodnju pravnih posledica administrativnog akta osim ako je drugačije određeno zakonom.

Odlaganje realizacije ovog projekta imaće za posljedicu poteškoće u njegovoj realizaciji ili čak nemogućnost realizacije ovog programa, zbog rokova koje je odredio donator, u ovom slučaju Norveška ambasada.

S obzirom da su sredstva za realizaciju ovog programa donacija Norveške ambasade i iz raznih razloga je realizacija ovog programa kasnila, KPZ je dobila dodatni rok za realizaciju ovog programa od strane Ambasade, period od šest meseci, koliko je i predviđeno trajanje programa stažiranja.

U slučaju da praksa studenata ne počne do isteka roka za žalbu, donator može otkazati ovaj program.

U ovom slučaju smatramo da će biti pričinjena neposredna i nenadoknadiva šteta po javni interes, jer kao što znate završene su sve procedure za izbor 100 pripravnika, također će biti onemogućeno održavanje pripravnčkog staža od strane ovih pripravnika, a shodno tome sredstva za realizaciju ovog programa biće vraćena donatoru. U trenutnoj situaciji smatramo da kao institucija moramo preduzeti sve zakonske mere da omogućimo realizaciju ovog projekta.

Nadalje, član 130 stav 130.3 Zakona o opštem upravnom postupku predviđa da se suspenzivno dejstvo žalbe može zabraniti ako kašnjenje u izvršenju upravnog akta može uzrokovati neposrednu i nepopravljivu štetu po javni interes.

Prema navedenom u gornjem tekstu, a po principu efikasnosti, odlaganje izvršenja može prouzrokovati neposrednu i nenadoknadivu štetu, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

## **PRAVNI SAVET**

Stranka nezadovoljna ovom odlukom ima pravo da uloži žalbu protiv odluke o obustavi suspenzivnog efekta Osnovnom sudu u Prištini – Odeljenje za administrativne poslove, u roku od pet (5) dana od dana prijema odluke.

Predsednik komisije

Xhavit Bulliqi

---

Potpis:




---

Zapisničar

*Andron Begri*

---

Potpis:



---